# DËSHMI ARKIVI

**A-441778**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Rama na preu në besë”, Divjaka kundër reformës territoriale: Nuk pranojmë bashkimin me Lushnjën |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391417.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 21:23:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 21:10:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 21:09:00 UTC → 13 shtator 2026, 21:11:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c78ae4a19ec99121d3dd28e87f0a9850092087bd4ebe86db1a4b91b256a9a5ac` |
| TEKSTI | `e36db328f47bcdb3864ac726c4bd9d13865dc09c09f49b7bd5b2366ee22cbacb` |
| PAMJA | `46932a1345d63f4dc18c34eadeb3927b8951ea2764097b5e9b6130624a2f5d07` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `84bf42d0fbfcda77022df609525a30eae76723b1af86da3a64a37230cf377d8f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f1c1a38f9771f79e512f664e18e6e88db80fe93efd6d7ebfef0798630764110e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/84bf42d0fbfcda77022df609525a30eae76723b1af86da3a64a37230cf377d8f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Rama na preu në besë”, Divjaka kundër reformës territoriale: Nuk pranojmë bashkimin me Lushnjën

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 13.09.2026, 23:10

Share Share



Banorët e Divjakës vijojnë protestat kundër reformës së propozuar territoriale, që sipas tyre synon shkrirjen e Bashkisë Divjakë dhe përfshirjen e saj në Bashkinë Lushnjë.

Prej 45 ditësh, qytetarët janë mbledhur në shesh për të kundërshtuar këtë projekt, duke kërkuar që Divjaka të vijojë të jetë bashki më vete. Protestuesit argumentojnë se historia, identiteti dhe të dhënat demografike të zonës dëshmojnë, sipas tyre, se Divjaka i përmbush kriteret për të ruajtur statusin e saj.

Banorët shprehen të vendosur për ta vijuar betejën e tyre, ndërsa kundërshtojnë atë që e konsiderojnë si një vendim të marrë nga qeveria për bashkimin e Divjakës me Lushnjën.

Edhe në mbrëmjen e 45-të të protestës, qytetarët kanë vijuar me marshimin në rrugët e qytetit, duke përsëritur thirrjet për ruajtjen e Bashkisë Divjakë dhe slogane të tjera kundër reformës së propozuar.

Ndërkohë, të hënën, në orën 16:00, Komisioni i Këshillit Bashkiak Divjakë dhe përfaqësues të bashkisë do të zhvillojnë një takim të zgjeruar me qytetarët, ku pritet të diskutohen qëndrimet dhe shqetësimet e komunitetit lidhur me reformën territoriale.

Këshilli Bashkiak Divjakë ka votuar kundër kësaj reforme që në fillim të gushtit, gjatë një mbledhjeje të jashtëzakonshme të zhvilluar pikërisht për këtë çështje.

Të dhënat, argumentet dhe kërkesat e banorëve të Divjakës dhe njësive administrative përkatëse pritet t’i përcillen në ditët në vijim Kuvendit dhe Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.